

**Formular për SYLLABUS të Lëndës**

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë / Stomatologji
Titulli i lëndës:	<b>Farmakologji me Toksikologji</b>
Niveli:	
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i III <sup>të</sup> , semestri i V <sup>të</sup> dhe semestri i VI <sup>të</sup>
Numri i orëve në javë:	2 orë ligjërata dhe 2 orë ushtrime
Vlera në kredi – ECTS:	<b>3 + 4 ECTS</b>
Koha / lokacioni:	Semestri dimëror dhe semestri veror/ Fakulteti i Mjekësisë
Mësimdhënësi i lëndës:	<i>Prof. Dr. Shaip Krasniqi</i> <b>Asistentët:</b> <i>Ass. Dr. Flaka Pasha</i>
Detajet kontaktuese:	<i>Prof. Dr. Shaip Krasniqi</i> (Instituti i Farmakologjisë me Toksikologji, telefoni lokal 500-600-2012) Konsultimet E mërkure ora 10:00 – 11:00 <a href="mailto:shaip.krasniqi@uni-pr.edu">shaip.krasniqi@uni-pr.edu</a> :  <i>Ass. Dr. Flaka Pasha</i> Instituti i Farmakologjisë me toksikologji – flaka.pasha@uni-pr.edu konsultimet : Henë 10-12.00
Përshkrimi i lëndës	
Përshkrimi i lëndës	Farmakologjia është degë e mjekësisë e cila ka të bëjë me studimin e veprimit të barit. Në mënyrë më specifike, paraqet studimin e ndërveprimeve që ndodhin në mes të organizmit të gjallë dhe substancave kimike që ndikojnë në funksionin biokimik normal apo jonormal. Nëse substancat kanë veti mjekësore, ato konsiderohen si medikamente. Kjo fushë përfshinë përbërjen e barit dhe vetitë e tij, ndërveprimet, toksikologjinë, terapinë, aplikimin mjekësor dhe kapacitetet antipatogjenike. Dy fushat kryesore të farmakologjisë janë farmakodinamika dhe farmakokinetika. E para studion veprimin e medikamentit në sistemet biologjike, ndërsa e dyta studion efektin e sistemeve biologjike në medikament. Në terma më të gjerë, farmakodinamika shtjellon ndërveprimin e substancave kimike me receptorët biologjikë, dhe farmakokinetika shtjellon absorbimin, distribuimin, metabolizimin dhe ekskrecionin e substancave kimike nga sistemet biologjike.
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohja me principet bazë të farmakologjisë së përgjithshme.</li> <li>• Aftësimi i studentëve për demonstrimin e njohurive esenciale për grupet kryesore të barnave, sidomos të farmakokinetikës dhe të farmakodinamikës së</li> </ul>

	<p>barnave-prototipë për grupet e mëdha të barnave.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aftësimi i studentëve për përcaktimin kritik të indikimeve dhe të kundëringdikimeve për shfrytëzimin e barnave të caktuara.</li> <li>• Njohja me rëndësinë e ndërveprimeve bari-bari dhe zhvillimin e aftësive për prevenimin e interaksioneve të tilla, me qëllim të aplikimit të barnave me benefit maksimal.</li> <li>• Pajisja e studentëve me njohuritë për principet e përgjithshme të parandalimit dhe të trajtimit të gjendjeve toksike, të shkaktuara nga substancat kimike të cilat nuk shfrytëzohen për terapi, si dhe të helmimeve me grupet më të shpeshta të barnave.</li> </ul>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të jetë i aftë të njohë principet bazë të farmakologjisë së përgjithshme.</li> <li>2. Të jetë i aftë për demonstrimin e njohurive esenciale për grupet kryesore të barnave, sidomos të farmakokinetikës dhe të farmakodinamikës së barnave-prototipë për grupet e mëdha të barnave.</li> <li>3. Të jetë i aftë për përcaktimin kritik të indikimeve dhe të kundëringdikimeve për shfrytëzimin e barnave të caktuara</li> <li>4. Të jetë i aftë për identifikimin e interaksioneve bari-bari dhe zhvillimin e aftësive për prevenimin e interaksioneve të tilla, me qëllim të aplikimit të barnave me dobi maksimale.</li> <li>5. Të jetë i aftë për aplikimin e principeve të përgjithshme të parandalimit dhe të trajtimit të gjendjeve toksike, të shkaktuara nga substancat kimike të cilat nuk shfrytëzohen për terapi, si dhe të helmimeve me grupet më të shpeshta të barnave</li> </ol>

**Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)**

<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	30	60
Ushtrime teorike/laboratorike	2	30	60
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	4	4
Ushtrime në terren			
Kollokfiume, seminare	3		3
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgaditja përfundimtare për provim	2	20	40
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz,	3		3

provim final)			
Projektet, prezentimet ,etj			
<b>Totali</b>			<b>190 (7 ECTS)</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>			
	Organizimi i mësimit teorik dhe praktik (me metoda bashkëkohore ndërvepruese; punë seminareske në grupe të vogla, PBL metoda).		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>			
	<p>Metodat e vlerësimit: Në vlerësim duhet të caktohet përqindja e pjesëmarrjes së secilit vlerësim parcial ose intermediar në vlerësimin definitiv. Një nga mënyrat e vlerësimit mund të jetë:</p> <p>Vlerësimi i parë: 5% (vlerësimi 1 deri 5 pikë)  Vlerësimi i dytë 5% (vlerësimi 1 deri 5 pikë)  Vijimi i rregullt 10% (vlerësimi 1 deri 10 pikë)  Provimi final 80%</p> <p>Gjithsej 100% (100 pikë maksimum)  Në kolokfium studenti mund të arrij 5 pikë maksimum, dhe duhet të kaloj pragun prej 50%)  Për vijimin e rregullt, studenti vlerësohet me pikë nëse kalon vlerën mbi 80% të ligjëratave. Nëse vijueshmëria është 50-79% e ligjëratave, studenti obligohet me angazhime shtesë (p.sh. seminare), ndërsa nëse vijueshmëria është më e ultë se 50%, atëherë studentit i pamundësohet hyrja në provim dhe obligohet që të dëgjoj ligjëratat në vitin vijues.</p>		
<b>Literatura :</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Basic &amp; Clinical Pharmacology, Bertram G Katzung. 12th edition, 2012</li> <li>2. <b>Pharmacology (Lippincott's Illustrated Reviews Series) by Richard A. Harvey, Michelle A. Clark, Richard Finkel and Jose A. Rey (Jul 17, 2012)</b></li> <li>3. Principles of Pharmacology (The Pathophysiologic basis of drug therapy) David E. Golan, Armen H. Tashjian, Jr., Ehrin J. Armstrong, Second Edition, 2008</li> <li>4. Hilmi Islami, Mentor Disha. "Receptura Mjekësore", 2001, Prishtinë</li> </ol>		
<b>Literatura shtesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Goodman and Gilman. The Pharmacological Basis of Therapeutics, 12th edition, 2011</li> </ol>		
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>			
<b>SEMESTRI I PARË</b>			
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>		
<b>Java e parë:</b>	Prezantimi i syllabusit Hyrje në Farmakologji - Farmakologjia e përgjithshme		
<b>Java e dytë:</b>	Hulumtimi i barnave të reja Administrimi i barnave		
<b>Java e tretë:</b>	Fati i barit në organizëm – Farmakokinetika e barnave		

<b>Java e katërt:</b>	Veprimet e barnave – Farmakodinamika e barnave
<b>Java e pestë:</b>	Ndërveprimet e barnave
<b>Java e gjashtë:</b>	Efektet anësore të barnave Autakoidet
<b>Java e shtatë:</b>	Farmakologjia e Sistemit nervor vegjetativ (1)
<b>Java e tetë:</b>	Farmakologjia e Sistemit nervor vegjetativ (2)
<b>Java e nëntë:</b>	Farmakologjia e Sistemit nervor qendror (1)
<b>Java e dhjetë:</b>	Farmakologjia e Sistemit nervor qendror (2)
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Anestetiket lokal dhe te përgjithshëm
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Farmakologjia e Sistemit Respirator
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Farmakologjia e e organeve hemopoetike dhe gjakut
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Vlerësimi i i parë intermediar
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Seminare
<b>SEMESTRI I DYTË</b>	
<b>Java e parë:</b>	Farmakologjia e Sistemit Kardiovaskular (1)
<b>Java e dytë:</b>	Farmakologjia e Sistemit Kardiovaskular (2)
<b>Java e tretë:</b>	Farmakologjia e traktit gastrointestinal
<b>Java e katërt:</b>	Farmakologjia e hormoneve
<b>Java e pestë:</b>	Farmakologjia e vitaminave dhe mineraleve
<b>Java e gjashtë:</b>	Barnat antimikrobike (1)
<b>Java e shtatë:</b>	Barnat antimikrobike (2)
<b>Java e tetë:</b>	Barnat antimikrobike (3)
<b>Java e nëntë:</b>	Barnat antimikrobike (4) dhe substancat tjera
<b>Java e dhjetë:</b>	Farmakoterapia citostatike dhe imunofarmakologjia
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Substancat me veprim lokal-dezinfektuesit dhe antiseptikët
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	<b>Bazat e Toksikologjisë (1)</b>
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Bazat e Toksikologjisë (2)
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Substancat për kontraste rentgenologjike
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Vlerësimi i dytë intermediar dhe Seminare

#### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

(1) Këshilli i njësive akademike i përjashton nga Universiteti përgjithmonë ose përkohësisht studentët që i shkelin rëndë rregullat. Studentët e akuzuar për shkelje kanë të drejtë të dëgohen nga komisioni disiplinor i cili e këshillon këshillin e njësive akademike. Studentët e përjashtuar kanë të drejtë t'i ankohen Senatit i cili mund të konfirmojë ose të refuzojë vendimin e këshillit të njësive akademike.

(2) Rregulloret që i elaborojnë këto procedura nxirren nga Senati pasi të jenë konsultuar me parlamentin e studentëve.

(3) Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit të marrë prej organeve të Universitetit, të njësive akademike dhe njësive organizative që kanë të bëjnë me të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.

(4) Ankesat e tilla i dorëzohen komisionit të studimeve të njësive akademike brenda 15 ditëve të punës pas shpalljes së vendimit.

(5) Komisioni i studimeve është i obliguar t'ia dorëzojë raportin për vendimin e marrë këshillit të njësive akademike brenda 30 ditëve të punës pas pranimit të ankesës.